



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-7353/24 datë: 21.03.2024



Npi – 01/113 datë: 27.03.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 27.03.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 27.03.2024 (e mërkurë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Drejtori z.Besnik Ahmeti, nga zyra për informim znj.Vlora Hyseni, nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri, praktikante znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 23.02.2024,
2. Propozim-Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmerisë NPKSH “Higjena” dhe “Kryqit të Kuq të Kosovës” në Shtime,
3. Pasqyrat Financiare për vitin 2023,
4. Propozim-Vendim për miratimin e vlerësimit të dëmeve të FN&FT për Janar-Tetor 2023,
5. Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2022-2024 (diskutim publik)
6. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës por një pikëpyetje e qes për pikën e dytë të rendit të ditës, sepse duhet ta kemi një informatë më të detajuar. Do të ishte mirë që të jetë drejtori prezent për këtë pikë prandaj unë propozoj që me largu këtë pikë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Edhe unë mendoj se është mirë me e larguar këtë pikë nga rendi i ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht e miratoi renin e ditës duke e larguar pikën 2 “Propozim-Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmerisë NPKSH “Higjena” dhe “Kryqit të Kuq të Kosovës” në Shtime”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 23.02.2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Konstatoj kuorumin prej 7 anëtarëve prezent.

***Komiteti për Komunitete, unanimsht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 23.02.2024.**

Pika 2

Pasqyrat Financiare për vitin 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Përshëndetje, ne e kemi obligim ligjor që ta prezantojmë pasqyrat financiare. Materialin e keni marrë me kohë dhe besoj e keni lexuar, e unë do ta prezantoj në Komitet me shifrat kryesore financiare nëpër kodet buxhetore. Në vazhdim lexoi dokumentin (shih dokumentin) me shuma sipas sipas kodeve buxhetore. Nëse ka ndënjë pyetje unë jam i gatshëm që të përgjigjem.

z.Besnik Seferi; Meqenëse raporti i ka kryer procedurat e veta. Unë e kam një pyetje se si ka qenë i realizuar buxheti te ZKKK-ja për vitin 2023?

z.Besnik Ahmeti, DBF; Te pasqyrat financiare nuk janë për secilën drejtori ose sektorë të pasqyruara në detaje, në detaje mund ti merrni vetëm te drejtoritë përkatëse.

z.Besnik Seferi; Unë të falenderoj për këtë informatë e kuptoj që në këtë raport nuk janë të detajuara të gjitha shpenzimet për të gjithë sektorët.

Pika 3

Propozim-Vendim për miratimin e vlerësimit të dëmeve të FN&FT për Janar-Tetor 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, unë jam për me i rekomanduar Kuvendit për miratim. Sa e di unë Qeveria e ka marrë përsipër për me i kry pagesat.

z.Besnik Seferi; Me njëfar forme po ja hupim kuptimin këtijë Komiteti, sepse nuk po merr pjesë në mbledhje drejtori për të na sqaruar. Mendoj se duhet bërë rekomandim për Kuvendin me qëllim që të paguhen edhe ata që janë dëmtuar. E dimë që Komuna nuk i paguan dëmet por Qeveria. Fokusi duhet me u ndalë te komunitetet.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Mendoj se nuk duhet me i kaluar rekomandimet pa pasur informata nga drejtorja, sepse sikur po mësohen që me i kaluar edhe pa marrë pjesë fare në mbledhjet e Komitetit.

z.Muhamet Mehemti; Përshëndetje, qysh po e shoh në listë nuk ka asnjë pjestar të komunitetit ashkali, nuk e di a ka pas nevojë, mirëpo nuk po e kemi drejtorin prezent për me na informuar. Mungesa e zyrtarit të ZKKK-së e ka luajtë rolin e vetë, por unë jam i mendimit se ne duhet me e votuar rekomandimin për Kuvendin.

*** Komiteti për Komunitete, me 6 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për vlerësimin e dëmeve të FN&FT për Janat-Tetor 2023.**

Pika 4

Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2022-2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Është i formuar grupi punues që ka punuar, ndoshta Muhameti mundet me na informuar më shumë. Ky draft është i harmonizuar me nivelin qëndror.

z.Muhamet Mehemti; Me vendimin e Kryetarit është formuar grupi punues ku grupi ka 13 anëtarë, kurse nga Komuniteti, kanë qenë 4 anëtarë të grupit punues. Na ka ndihmuar një përfaqësues ndërkombëtarë. E kemi bërë një draft të Planit të veprimit, drejtorat kanë qenë prezent në takimet e punës dhe secili ka kontribuar në fushën e vetë. Me planin e veprimit jemi tepër vonë, por më mirë vonë se hiq. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Besnik Seferi; Është mirë që është bërë ky draft-plan, dhe po besoj që gjatë diskutimit publik, secili e ka mundësinë me kontribuar në këtë plan. Mendoj se Zyra për Komunitete dhe Kthim është kryesore që duhet të funksionalizohet, sepse shumë çka varet nga kjo zyre për Komunitete.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Në takimin e fundit me Kryetarin kemi biseduar për angazhimin e zyrtarit në zyrën për Komunitete. Rekomandoj që diskutimi publik të organizohet në dy forma, një në sallën e Kuvendit dhe një në fshatin Gjyrkovc.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues nga OSBE; Përshëndetje, në muajin Janar kemi pas takim me Kryetarin dhe na ka thënë që në muajin Shkurt të hapet Konkursi. E them me keqardhje por në Draft-plan vetëm 3 persona kanë punuar, të tjerët kanë mbledhur informacione. Ky dokument flet për shuma të mëdha. Dokumenti nuk është kryer me kohë. Ne si OSBE e kemi një qasje ashtu që u është lënë juve për ta punuar. Kjo është një Strategji e cila kërkon punë dhe angazhim të madh.

z.Arton Demiri; Kryetari nuk don me pas bashkpunim me Komunitetin, unë i kamë qu duart prej kësaj Komune. Dy herë e kemi pritë Kryetarin dhe nuk na ka takuar. Kjo është marre. Kjo është një ditë që festohet në krejt botën dita e flamurit.

z.Muhamet Mehmeti; Kjo duhet me dalë në dëgjim publik, ne kemi punuar mjaftë shumë. Si ekspertë ka punuar Ibrahim Demiri. Ne e dimë se sa është implementuar plani më herët, por nuk po duam me hy në këtë pjesë. Ka pasë një propozim për përmirësim të dokumentit nga Reshat Gashi që kishte të bënte me diskriminim dhe e kemi përmirsuar. Strategjia është prezantuar me Video-projektor, dhe secila drejtori e ka dhënë kontributin e vetë, unë thash më herët, se ne tash e kemi bërë një draft-plan dhe kaq kemi pas ne mundësi.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik Draft-Planin lokal të veprimit për komunitetet Rom dhe Ashkali për periudhën 2024-2026 me rekomandimin që procesi i diskutimit publik të organizohet në Shtime, Gjyrkovc dhe Vojnovc.**

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Më 4 Prill 2024 fillon regjistrimi i popullsisë, informata e parë, e dyta është që më ka ikur dita e diskutimit për flamurin Rom, se çka po veprohet tutje.

z.Muhamet Mehmeti; Një informatë e kam prej drejtorit të QPS-së që për personat që kanë nevojë e që nuk marrin ndihma sociale, 50 familje kanë marrë pako ushqimore nga OJQ "Katari" që ishte donatorë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ministria për punë të brendshme e ka hapur konkursin për 10 vende të punës për pjestarët e Komunitetit pakicë në nivel qendror dhe në nivel lokal.


z.Arton Demiri; Ne e kemi dërguar një kërkesë te DKRS-ja në vlerë prej 300 euro për ditën ndërkombëtare të Romëve. Jeni të ftuar të gjithë anëtarët e Komitetit.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Çka po bëjmë me Komitetin?

z.Muhamet Mehmeti; Ne e kemi bërë rekomandimin qe dy vjet e nuk po merret parasyshë. Unë po propozoj që të gjithë anëtarët e Komitetit të bëjmë një takim pune me Kryetarin.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Kur ta caktojmë takimin ju lus që me qenë të gjithë prezent dhe me i diskutuar të gjitha çështjet. Ju falenderoj për punën, jam i nderuar që jam bashkë me ju duke punuar dhe ju falënderoj. Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:54h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi,

